



Nr. 03/14

Datë: 24.10.2014

Prishtinë

*Në mbështetje të nenit 9 pika 2 dhe të nenit 106 pika 1 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame (në tekstin e mëtejme FSI), në mbështetje të propozimit të Komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për studime në FSI, Këshilli Mësimor-Shkencor i FSI-së në mbledhjen e mbajtur më datë 24.10.2014 Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës i propozon:*

## **RREGULLOREN**

### **Për sistemin tutorial në Fakultetin e Studimeve Islame**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore synohet të rregullohet puna e sistemit të tutorimit në Fakultetin e Studimeve Islame.

#### **Neni 2**

Qëllimi i sistemit të tutorimit është që të krijojë kushte për:

- a) Vendosjen e linjës së drejtpërdrejtë ndërmjet studentit dhe profesorit;
- b) Integrimi i studentit në ambientin e Fakultetit
- c) Krijimi i klimës për të arritura më të larta të studentëve dhe ngritja e cilësisë së mësimimit

### **Neni 3**

Veprimtaria tutoriale mund të kryhet nga profesori dhe studenti

### **Neni 4**

Tutor mund të jetë studenti i rregullt i cili së paku është regjistruar në vitin e tretë akademik dhe ka notë mesatare mbi nëntë (9.0) dhe i cili aplikon para komisionit për zgjedhjen e tutorit. Në mungesë të kandidatëve me notë mesatare (9.0) për pozitë të tutorit mund të zgjedhet edhe kandidati me notë më të ulët.

### **Neni 5**

Mandati i studentit tutor zgjat një vit me mundësi të përsëritjes. Zgjedhja e tutorit bëhet në fillim të çdo viti akademik.

### **Neni 6**

Studenti tutor njëkohësisht përfaqëson studentët në KMSH.

### **Neni 7**

Qëllimi i studentëve tutor është si vijon:

- a) Studentët të cilët i udhëheqë (mbikëqyrë), t'i informojë me të gjitha aspektet ligjore dhe aspektet tjera dhe veçanërisht rreth të drejtave dhe detyrave të studentit;
- b) Që studentët e udhëhequr t'i këshillojnë në tejkalimin e vështirësive në procesin edukativ;
- c) Të mbajë evidencë për punën me studentët e mbikëqyrur

### **Neni 8**

Studenti tutor është i obliguar të raportojë çdo muaj tek komisioni për tutor për punën e tij dhe për rezultatet e arritura.

Raporti përpilohet me shkrim dhe në rast kur kërkon komisioni të njëjtin e prezanton edhe me gojë.

### **Neni 9**

Profesor tutor mund të jetë çdo profesor i angazhuar në Fakultetin e Studimeve Islame

#### **Neni 10**

Mandati i profesorit tutor zgjat prej fillimit të semestrit të parë deri në përfundim të studimeve të studentëve që i tutoron (mbikëqyrë).

#### **Neni 11**

Qëllimi i mësimdhënësve tutor është që të komunikojë direkt ose në mënyrë elektronike me studentin dhe ta këshillojë atë për të gjitha aspektet në veçanti për programet e caktuara.

#### **Neni 12**

Mësimdhënësi tutor po ashtu raporton çdo muaj tek komisioni për tutor rreth progresit të studentëve të tutoruar.

#### **Neni 13**

Procesi tutorial në Fakultetin e Studimeve Islame organizohet prej Komisionit Tutorial.

#### **Neni 14**

Qëllimet e këtij komisioni janë si vijon:

- a) Në bashkëpunim me dekanin e Fakultetit, komisioni në fillim të çdo viti akademik paraqet numrin e domosdoshëm të mësimdhënësve dhe studentëve tutor;
- b) Organizon përgatitjen profesionale të mësimdhënësve dhe studentëve tutor;
- c) Komisioni raporton me shkrim për aktivitetin e tij në fillim dhe në fund të çdo semestri tek dekani i Fakultetit

#### **Neni 15**

Dekani i Fakultetit obligohet që të informoj Këshillin e Fakultetit në mënyrë të rregullt për aktivitetin e Komisionit tutorial dhe sistemin tutorial në përgjithësi.

#### **Neni 16**

Në fund të çdo viti akademik, studenti tutor merr certifikatë për aktivitetin e tij në sistemin tutorial. Nëse komisioni tutorial e vlerëson atë si të suksesshëm i lëshon certifikatën si dëshmi për punën e tij tutoriale.

### **Neni 17**

Tutorët mësimdhënës dhe student duhet të stimulohen për aktivitetin e tyre. Pjesa financiare e kundërshpërblimit rregullohet me një tarifë të veçantë të cilën e parasheh KMSH.

### **Neni 18**

Komisioni tutorial përbëhet nga këta anëtarë:

Prodekani i Fakultetit

Një anëtar i KMSH-së

Shefi i zyrës për cilësi të mësimit

### **Neni 19**

Komisioni zgjedh kryetarin e tij brenda anëtarëve të vet.

### **Neni 20**

Komisioni tutorial për punën e tij i përgjigjet dekanit të Fakultetit. Të paktën në fillim ose mbarim të semestrit.

### **Neni 21**

Komisioni vendimet e tij i merr me shumicë votash.

### **Neni 22**

Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit.

### **Neni 23**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e BIRK-ut

### **Vërteton:**

Prof. asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan